



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

**PROJEKTI I KONKURRUESHMËRISË DHE GATISHMËRISË PËR
EKSPORT**

PROGRAMI I GRANTEVE TË PËRPUTHSHME

Shkurt, 2023

Programi i Granteve të Përputhshme – MGP Newsletter- Edicioni i vitit 2022 përmban arritjet kyçe përgjatë këtij viti të përmbledhura në katër tema kryesore:

- Zbatimi i projektit- 2022
- Disbursimi i granteve
- Ndikimi në ambient
- Storie suksesi

Urojmë të kënaqeni duke lexuar arritjet dhe rezultatet tona të përbashkëta, mbresëlënëse dhe ju urojmë një 2023 sa më prosperues!

RRETH PROGRAMIT TË GRANTEVE TË PËRPUTHSHME

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e Republikës së Kosovës është përgjegjëse për zbatimin e Projektit të Konkurueshmërisë dhe Gatishmërisë për Eksport (CERP), EUR 14.30 milionë, si hua e butë e dhënë nga Banka Botërore.

Qëllimi i Programit të Granteve të Përputhshme është të mbështesë ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të) me potencial të eksportit drejt:

- i) *Përmbushjes së kërkesave për zbatimin e standardeve dhe certifikimit të produktit të kërkuar për tregjet e eksportit,*
- ii) *Rritjes së aftësisë për gatishmëri të eksportit dhe*
- iii) *Rritjes së qasjes në Shërbimet e Zhvillimit të Biznesit (ShZhB)*

MINT ka themeluar programin e granteve të përputhshme brenda Njesisë së Menaxhimit të Granteve dhe gjatë fazës së parë, 25 grante iu janë dhënë firmave të selektuara nga Kosova. Projekti është ristrukturuar për t'iu përgjigjur nevoja për ndryshime të firmave edhe si rezultat i krizës së COVID-19.

Nënkomponent 1.1: Përkrahja e ndërmarrjeve mikro, të vogla, dhe të mesme për të përmirësuar gatishmërinë për eksport (EUR 10.40 milionë) si pjesë e Projektit të konkurueshmërisë dhe Gatishmërisë për eksport, është i rëndësishëm për qëllimin e operimit të Projektit të Granteve të Përputhshme (MGP)

Si pjesë e ristrukturimit të programit CERP dhe zgjerimit të programit të granteve, si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, menaxhimi i MGP u transferua te konsorciumin Prishtina REA & WEglobal, nën mbikqyrjen direkte të Njesisë së Implementimit të Projektit (PIU) të CERP dhe MINT përmes një procesi ndërkombëtar të hapur tenderimi.

Aktivitetet e financuara nga MGP, me ristrukturim dhe zgjerim përfshijnë:


Akt 1. Standardet ISO dhe Certifikim Produkti

Akt 2. Makineri prodhuese

Akt 3. Pajisje për vlerësime të konformitetit

Akt 4. Shërbime përkrahëse për zhvillim të biznesit

Akt 5. Pajisje të vogla të dedikuara veçanërisht për avancim digjital.



PROCESI I ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË GRANTEVE TË PËRPUTHSHME

Me valën e dytë të thirrjes për aplikim të hapur përgjatë korrikut 2021, janë pranuar **mbi 500 aplikime duke u përzgjedhur 142 prej tyre**, vlerësuar nga **komisioni i pavarur i përzgjedhjes së granteve**.

Ekipa e MGP ka organizuar info-sesione regjionale dhe sektoriale për të promovuar thirrjen dhe për të shpjeguar objektivat, kriteret dhe aktivitetet e përkrahura.

Marrëveshjet e Granteve u nënshkruan më 25 mars 2022, me kohëzgjatje njëvjeçare.



EVENTET KYÇE

Pas eventeve dhe info-sesioneve të kaluara të organizuara për promovimin e programit të granteve të përputhshme, zuri vend ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së granteve, duke mbledhur përfituesit e granteve dhe akterë kyq të programit.

SESSION TRAJNIMI

Implementimi i Granteve dhe Procedurat e Prokurimit

Janë ofruar sesione intensive trajnuese në zbatim të granteve dhe rreth procedurave të prokurimit për të gjithë grant-përfituesit, duke kaluar në temat kyçe:

- termet dhe kushtet e zbatimit të projektit
- rregullat dhe kushtet e prokurimit dhe kontraktimit
- raportimi, zbatimi i aktiviteteve dhe pagesa e grantit

Aktivitetet pasuese të ndërlidhura me implementimin e granteve dhe procedurat e prokurimit iu janë komunikuar vazhdimisht përfituesve, duke adresuar probleme të ndryshme; sqarime e pyetje rreth zbatimit të projektit apo procedurave të aktivitetit prokurues.

Sektorët FAQ dhe Q&A në platformën e MGP, janë përditësuar vazhdimisht, me ofrimin e pyetje-përgjigjeve. Përveç website-it të MGP, adresa elektronike dhe kanalet në mediat sociale janë përdorur gjithmonë për të shpërndarë të rejat e fundit të FAQ dhe Q&A tek përfituesit.

PRONËSIA E NDËRMARRJEVE MIKRO, TË VOGLA DHE MESME (NMVM) NË BAZË GJINORE

Programi i Granteve të Përputhshme e ka në konsideratë kontributin në përmirësim të barazisë gjinore dhe përkrahjen e gruas në ndërmarrësi përmes ndikimit të tij direkt në çështje dhe aktivitete ndërsektoriale.

Nxitja e ndërmarrësisë dhe përkrahja e NMVM me pronare gra ndikon në rritje ekonomike e sociale, duke kontribuar në sigurimin e krijimit të vendeve të qëndrueshme të punës, zhvillimin dhe nxitjen e bizneseve të grave, produkte të reja dhe inovacione, lehtësimin e lidhjeve me zinxhirë të vlerave, etj.

Programi i Granteve të Përputhshme ka kontribuar shumë në arritjen e këtij qëllimi, duke shtuar 10 pikë shtesë për NMVM me pronare gra gjatë evaluimit të aplikimeve, e që rezultoj me një numër të madhë aplikimesh e numër të kënaqshëm të përfituesve me pronësi grash.

Nga 137 përfituesë, janë 20 kompani në pronësi 100 % të grave , si dhe 8 nga to ndajnë nga 51 % deri në 80 % të pronësisë së aksioneve të NMVM dhe 4 NMVM ndajnë nga 20 % deri në 50% të pronësisë së aksioneve nga gratë.

TË DHËNAT KYÇE NGA AKTIVITETET E ZBATUARA NGA GRANT-PËRFITUESVE

Zbatimi i aktiviteteve nga grant-përfituesit monitorohen vazhdimisht nga Njësia Implementuese (Prishtina REA & WEglobal) përmes raporteve të zakonshme periodike, raporteve të aktivitetit, raporteve të ngarkuara në platformën online dhe vizitave monitoruese të rregullta.

Deri më tani, të dhënat kyçe të aktiviteteve të zbatuara nga grant-përfituesit tregojnë arritje të mëdha duke pasur në konsideratë vështirësitë esenciale që janë shfaqur, p.sh., rritjet e çmimeve në tregjet furnizuese, si çmimet për makineri prodhuese, pajisje e shërbime, e pastaj vonesa në pranimin e makinerive e pajisjeve të porositura si rezultat i krizës në zhvillimet globale.

Aktivitetet e Grantit	Numri i aktiviteteve	Numri i procedurave të prokurimit të aprovuara sipas aktiviteteve	Te implementuara	Te paguara	Duke u implementuar	Procedurat e prokurimit të pa aprovuara	Ne pritje
<i>Akt 1. Zbatimi i Standardeve dhe Certifikimi i Produkteve</i>	129	106	36	22	1	23	22
<i>Akt 2. Pajisje / Makineri</i>	125	99	53	40	3	26	40
<i>Akt 3. Pajisjet për Vlerësimin e Konformitetit</i>	8	4	1	1	0	4	1
<i>Akt 4. ShZhB/Trajnimi</i>	94	48	28	19	9	46	19
<i>Act 5. Pajisje te vogla</i>	29	18	8	8	1	11	8
TOTAL	385	275	126	90	14	110	90


NDIKIMI NË SHITJE DHE EKSPORT

Zhvillimi i tregjeve të reja dhe rritja rapide në eksport të NMVM, tregojnë një ndikim pozitiv të menjëhershëm, si impakt i Programit të Granteve të Përputhshme, përmes përkrahjes së tij të ofruar për certifikimin e produkteve dhe standardeve ISO drejt tregjeve të eksportit, fuqizimit të konkurrencës së NMVM të orientuara në prodhim për eksport dhe përmirësimit të transformimit digjital të biznesit.

Sipas regjistrimit të shitjeve të grant-përfituesve e pastaj të monitoruara nga MGP, NMVM-të eksportuan 2.07 milion EUR më shumë në 2022 krahasuar me vitin e kaluar.

Duke krahasuar vlerën e rritjes në eksport për nga madhësia e NMVM-e , ndërmarrjet e vogla (10 deri 49 punëtorë) kanë rritur eksportin për 1.44 milion EUR.

Shumica e rritjeve në eksport, rreth 24.17 % është arritur nga sektori i përpunimit të metalit, 21.52 % nga prodhimi i produkteve të ndërtimit dhe 15,42 % nga totali i shitjeve të raportuara në tregjet ndërkombëtare janë të eksportuara nga kompani me aktivitet primar në procesim PVC, aluminit dhe xhamit.



Shënim: mostra e NMVM është zgjedhur duke përdorur metodën e rastësisë.

Përmirësimi i proceseve të zhvillimit të biznesit si Standardet dhe Certifikimi i Produktit, investime në makineri prodhuese dhe pajisje, kapacitetet e

përmirësuar të ndërlidhura me vlerësimin e konformitetit, shërbimet për zhvillim biznesi dhe avancim digjital të një ndërmarrieje çuan në zhvillim të burimeve njerëzore gjithashtu.

Indikatorët kyç tregojnë një ndikim mbresëlënës rreth krijimit të perspektivës së punësimit nga Programi i Granteve të Përputhshme. Krahasimi i të dhënave bazë të vitit 2021 dhe raporteve lidhur me punësimin në 2022 deri më tani, tregojnë që rreth 115 punëtorë të rinj janë angazhuar nga grant-përfituesit të cilët tashmë janë në fazën e implementimit të granteve.

STANDARDET DHE CERTIFIKIMI I PRODUKTEVE- PËRKRAHJA E EKSPORTIT DHE ZHVILLIMIT TË TREGJEVE TË REJA

Kushte specifike, rregulla, certifikime dhe/ose standarde janë të detyrueshme për eksport në tregje ndërkombëtare. Pothuajse, çdo vend e definon standardin duke e lidhur direkt me kualitetin, sigurinë, ambientin e kushte tjera, si dhe për produktet apo shërbimet e ofruara nga ta.

Grant-përfituesit e programit MGP janë në progres drejt arritjes së certifikimit të produkteve/shërbimeve të tyre, duke marrur Standarde të Menaxhimit të Cilësisë dhe Sistemin e Menaxhimit Mjedisor. Tabela e mëposhtme tregon tipet më të kërkuara të standardeve dhe certifikimeve ndërkombëtare të produkteve të zbatuara e në certifikim e sipër nga përfituesit tanë.

CE Mark	# 20 produkte
Analiza kimike laboratorike	# 15 produkte
Analiza mikrobiologjike laboratorike	# 11 analiza per 15 produkte
Global GAP	# 4 kompani
HACCP Analiza e Hazardit dhe Pikat e Kontrollit Kritik	# 2 kompani
ISO 27001:2013 Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit	# 2 kompani
Iso 14001:2015 Sistemi I menaxhimit të mjedisit	# 28 kompani
ISO 22000:2018 Siguria në ushqim	# 4 kompani
ISO 45001:2015 Shëndeti dhe siguria në punë	# 21 kompani
ISO 50001:2018 Sistemi i menaxhimit të energjisë	# 7 kompani
ISO 9001:2015 Sistemi i menaxhimi të cilësisë	# 27 kompani
ISO PAS 99 Sistemi i integruar i menaxhimit	# 1 kompani

NDIKIMI NË AMBIENT

Të gjitha aplikimet e pranuar dhe të zgjedhura për financim, kanë ofruar sqarimin e tyre të detajuar sa i përket sistemit të menaxhimit mjedisor që përdorin apo planifikojnë të përdorin me përkrahjen e MGP.

Varësisht nga aktiviteti primar i biznesit, disa kërkesa e certifikime janë të detyrueshme sipas legjislacioneve shtetërore. 28 përfitues grantesh po zbatojnë ISO 14001:2015, një sistem menaxhimi mjedisor që një organizatë mund të përdorë për përmirësimin e performancës mjedisore. ISO 14001:2015 ka për qëllim të përdoret nga një organizatë që kërkon të menaxhojë përgjegjësitë e saja mjedisore në një mënyrë sistematike që kontribon në shtyllën mjedisore të qëndrueshmërisë.

Më poshtë, është prezantuar një listë e grant-përfituesve nga MGP që janë angazhuar në mbrojtjen mjedisore përmes riciklimit dhe aktiviteteteve të ngjashme biznesore:

- **REC PLAST Shpk**
- **AL-TEC Shpk**
- **MSM Shpk**
- **BTP HOLDING**

NDIKIMI I PROJEKTIT NË MJEDIS



REC PLAST Shpk ka investuar në makineri ricikluse, duke kontribuar në mbrojtjen e mjedisit përmes mbledhjes së mbeturinave nga plastika dhe riciklimin e tyre.

REC PLAST, një kompani e riciklimit të mbeturinave nga plastika, që gjendet në Vitomiricë/Pejë, përmes financimit të projektit ka investuar në makinën e peletizimit të plastikës e njohur edhe si granulator për plastikë, që përdoret kryesisht për përpunimin e mbeturinave industriale dhe bujqësore të plastikës. Makina e peletizimit të plastikës është e përshtatshme për mbeturinat më të zakonshme të plastikës si PP, PE, PS, ABS, PA, PVC, PC, POM, EVA, LCP, PET, PMMA dhe rigjenerime tjera plastikash si dhe granulime me ngjyra të përziera.

Mbështetja MGP do t'i mundësojë REC PLAST të zgjerojë modelin e tij të biznesit, i cili gjithashtu do të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet menaxhimit e grumbullimit të duhur të kapaciteteve të mbetjeve të riciklueshme. Gjithashtu, modeli i biznesit do të krijojë kushte të favorshme për punësim të qëndrueshëm të grumbulluesve informalë të përfshirë në këtë sektor duke i formalizuar ata. Përfituesi është fokusuar drejt zgjerimit dhe hyrjes në tregun e Turqisë dhe Gjermanisë duke eksportuar granula me përmbajtje plastike.



AL-TEC Shpk ka investuar në pajisje për të kontribuar në mbrojtjen nga ndotja prej mbetjeve të kafshëve

AL-TEC Shpk është prodhuesi i Poppins, një markë kosovare e ushqimit për qen dhe mace, miratuar nga AUVK, për përpunimin e mbetjeve shtazore. Standardet e reja ISO të marra përmes Programit të Granteve Përputhshme e shtynë kompaninë një hap përpara në ndërmarrjen e zgjerimit, veçanërisht në eksport, siç janë këto standardet që nevojiten në mënyrë kritike për të operuar në tregun e BE-së.

AL-TEC Shpk është certifikuar me ISO 9001:2015 Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë, ISO 14001:2015 Sistemi i Menaxhimit Mjedisor dhe ISO 22000:2018 Menaxhimi i Sigurisë Ushqimore.

Përfituesi ka rritur gjithashtu, kapacitetin e prodhimit nga 250 kg/orë në 400 kg/orë, nëpërmjet investimit në Parakondicienerin për përpunimin e proteinave në ushqim. Më parë, AL-TEC shpk, mezi mbulonte nevojat e tregut të vendit. Në fakt, Poppins është në negociata me partnerin nga Shqipëria, dhe së shpejti do të nisë eksportet atje nga fillimi i vitit 2023.

Pajisja e dytë, e financuar nga projekti MGP është Dry Room, e cila do të mundësojë produkte të reja në treg si ëmbëlsira për kafshët shtëpiake, si big nose, pig ears, cow horns etj. Këto produkte kanë një raport shumë të mirë përfitimi pasi lënda e parë është lehtësisht e arritshme me çmim të lirë dhe përgatitet lehtë poashtu. Në këtë drejtim, do të kontribuojë edhe AL-TEC për mbrojtjen e mjedisit, pasi këto mbetje shtazore hidhen dhe nuk përdoren për ndonjë gjë tjetër.

MSM Shpk - eksportues kosovar i ushqimit për kafshë në SHBA

MSM SHPK është gjithashtu një prodhues i ushqimeve për kafshë shtëpiake me vendndodhje në Prizren. Të dhënat e disponueshme për MSM Shpk nga Regjistri i Doganës së SHBA, tregojnë se grant-përfituesi është eksportues i rregullt i produkteve të saj për disa kompani kryesisht në Florida.

Për të rritur kapacitetet e saj, MSM Shpk po investon në pajisje të reja si: Frigorifer dhome me shtrirje të temperaturave: +2/+10c, tharëse me dimension 85m³, temperaturë maksimale 90c, rregullator digjital dhe termoizolim me panele leshi mineral me përmasa 8cm, pajisje për përpunimin e lëkurës me kapacitet 180 litra, fuqia elektrike 1.5 KW, material inox, pajisje për prerjen e mishit me kocka me kapacitet 600 kg/orë inoks material etj.

MSM Shpk po zbaton gjithashtu HACCP (Hazard Analysis Critical Control Point) që është përcaktuar si një sistem menaxhimi në të cilin siguria ushqimore trajtohet përmes analizës dhe kontrollit të rreziqeve biologjike, kimike dhe fizike nga prodhimi i lëndës së parë, prokurimi dhe dorëzimi te prodhimi, shpërndarja dhe konsumi i produktit të përfunduar. Qëllimi i HACCP është të parandalojë dhe reduktojë shfaqjen e rreziqeve të sigurisë ushqimore.

Shpati-AM dhe brendi i tij Viola



Shpati-AM është themeluar në vitin 2004 në Republikën e Kosovës dhe që nga fillimi i tij është bërë një prodhues i rëndësishëm në Kosovë. Gjatë këtyre viteve, kompania është specializuar në prodhimin e tubave fleksibil dhe në vendosjen e marrëdhënieve komerciale me bizneset në Kosovë dhe eksportit në tregjet evropiane.

Profili i produkteve përfshin një markë të quajtur VIOLA. Falë projektit, Shpati-AM ka investuar në pajisjen e re Hose crimper machine and Assemble sleeve machine. Kompania është gjithashtu e certifikuar me ISO 9001:2015- Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë.

<https://www.youtube.com/watch?v=tkzm-UdQce0>

S//Sprint - prodhues i produkteve të tekstilit



S//SPRINT është ndër kompanitë më të mëdha vendase në sektorin e prodhimit të tekstilit me cilësitë më të larta dhe shumë efikase. S//Sprint, është një biznes me rritje të shpejtë, që sfidon shumë konkurrencën vendore dhe ndërkombëtare, dhe zhvilloi një identitet të njohur të markës. S//Sprint merret me prodhimin e veshjeve sportive, veshjeve të femrave, bluzave, këmishave dhe duksave, pantallonave/veshjeve të shkurtra femërore etj, që janë veshje shumë tërheqëse, me klasë, duke krijuar një markë të re të njohur ‘S//Sprint’, duke zëvendësuar importet e produkteve të ngjashme. Për shkak të dinamikës së punës dhe kërkesës për prezencë në treg, kompania ka rritur kapacitetin prodhues, me çrast kanë trefishuar numrin e punëtorëve (mbi 92% femra). S//Sprint synon të bëhet modeli kryesor dhe më i mirë i një biznesi në rritje, duke përfshirë një zinxhir furnizues të vlefshëm nën menaxhimin e tij dhe duke prodhuar lëndën e tij të parë, si shembulli më i mirë në vend, duke siguruar një qëndrueshmëri stabile dhe cilësi të lartë për tregun e shitjeve. Falë projektit, S//Sprint ka investuar dhe është certifikuar edhe me ISO 9001:2015-Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë dhe Sistemi i Menaxhimit Mjedisor ISO 14001:2015, si dhe makineritë automatike prerëse, duke synuar përmbushjen e kërkesave dhe pritjeve të tregut të BE-së.

<https://www.facebook.com/watch/?v=697187038488411>



BKM AGROKRUSHA Shpk- instaloi linjën e plotë automatike të prodhimit të AJVAR-it

BKM Agro Krusha Shpk ndodhet në fshatin bujqësor Krusha e Madhe në komunën e Rahovecit, Kosovë. Ajo drejtohet nga Emire Duraku, një grua sipërmarrëse e suksesshme, e cila arrin të kultivojë rreth 15 hektarë të mbjella me perime për prodhimin e ajvarit dhe turshive.

MGP Kosova ka mbështetur BKM AGROKRUSHA për të investuar në linjën e plotë të prodhimit të ajvarit, makinën larëse për perime, rripin selektues, frezë, makineri për paketim dhe mbushje të kavanozëve, furrë, pasterizator dhe makinë automatike ambalazhimi. Linja e prodhimit i ka ndihmuar ata të transferojnë prodhimin e tyre nga ai manual në procesin e prodhimit automatik të prodhimit.

BKM AGROKRUSHA tani është e certifikuar edhe me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, Mjedisi Sistemi i Menaxhimit ISO 14001:2015 dhe HACCP.

Kompania pret të rrisë shitjet e saja të eksportit në 20% ndërsa vendet e saj të synuara janë Franca dhe Shqipëria.



Heinze Shpk investon në makineri të avancuara me synim të lancimit të produktit të ri

Heinze Shpk, është ndër fabrikat më të rralla globalisht që prodhon produktin më të ri inovativ, i quajtur Cobiax. Mbi 90% e prodhimit eksportohet në tregun e BE-së dhe SHBA-së. Falë projektit MGP, Heinze Shpk ka investuar në një makineri të re Litz DV-1000 Vertical Machining centre, e cila përfshinë karakteristika të përpunimit të nivelit të lartë si boshti i drejtimit të drejtpërdrejtë, sistemi i ndarjes së ftofjes së vajit dhe rripi transportues opsional i çipave. DV-800 ka gjithashtu një panel kontrolli digjital të rrotullueshëm me kontroll të plotë, ekran funksioni dhe ekrane diagnostikuese. Makineria e re lejon saktësi ekstreme të prerjes dhe përsëritshmëri. Heinze Shpk gjithashtu ka implementuar dhe është certifikuar me sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015, Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001: 2015 dhe shëndeti dhe siguria në punë, Sistemi i menaxhimit (OHS) ISO 45001:2018.

Si rezultat i projektit MGP, Heinze shpk parashikon një rritje prej më shumë se 7% në eksport dhe lansimi i një produkti të ri Power box.

Makinë e re e derdhjes me injeksion plastik për AEG SHARR Shpk



AEG SHARR është themeluar në vitin 2002, me vendndodhje në Dragash dhe është e specializuar në prodhimin e ambalazheve nga plastika për industrinë ushqimore dhe kimike.

Aktiviteti kryesor i kompanisë është prodhimi i ambalazheve duke përdorur kryesisht PET, PE dhe HDPE që përdoren kryesisht për industrinë e pijeve, industrinë e qumështit, industrinë kimike, prodhimin e shampove dhe detergjentë, kozmetikë dhe farmaci. AEG SHARR prodhon mbi 200 produkte të ndryshme.

Falë projektit, përfituesi ka investuar në makinën e derdhjes me injeksion plastik e cila është projektuar posaçërisht për formimin me shpejtësi të lartë të produkteve të paketimit si kapak, mbyllje, enë të ushqimit të shpejt dhe produkte të tjera me mur të hollë. Ai përdor gjithashtu teknologji të avancuar për të ofruar dizajnin më të mirë dhe performancë të besueshme me një kohë të shkurtër të ciklit të formimit.

Përfituesi gjithashtu po implementon dhe së shpejti do të certifikohet me Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001, Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë (OH&S) 45001 dhe Menaxhimi i sigurisë me sistemet ISO 28000.

AEG Sharr është gjithashtu në procedurën e testimit të Plastic JAR 1300 për vendosjen e CE MARK e cila luan një rol jetik në garantimin e sigurisë së produktit për eksport në Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE).

AEG Sharr pret një rritje prej 20% të eksportit pas zbatimit të projektit dhe përafërsisht 5 Punonjës të rinj në 2023.

Do të kthehemi me plot energji pozitive dhe motivim që nga 3 janari 2023.

E dimë se 2023 do të jetë një vit sfidues, me shumë sfida të reja dhe zhvillime, pra, Programi i Granteve të Përputhshme Ju uron të gjithëve një 2023 të lumtur dhe të frytshëm!